



## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

### RAPORT

#### Takimi i Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa

Tiranë, 26 - 28 Tetor 2011

PËR: z. Ertan Munoglu - Menaxher programi në AKK

NGA: Arta Berisha Bajrami - Koordinatore për Mirëqenie Sociale

KOPJE: Z. Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së

SUBJEKTI: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa

DATE: 26 - 28 Tetor 2011, Hotel Doro - Tiranë



## Hyrje

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e radhës së Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa, kryesuar nga Kryesuesja znj. Afërdita Grapci dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z. Sazan Ibrahim, mbajtur prej 26 deri 28 Tetor 2011 në Hotel Doro City – Tiranë/Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë Drejtorët për Buxhet dhe Financa nga Komunitet: Prishtinë, Fushë Kosovë, Rahovec, Ranilluk, Novobërdë, Gjilan, Junik, Pejë, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit, Prizren, Klinë, Istog, Mamushë, Drenas, Skenderaj, Mitrovicë, Gjakovë, Shtime, Ferizaj, Junik dhe Podujevë. Po ashtu të ftuar ishin tre Ministritë relevante: MPMS – z. Mentor Morina, MAPL - z. Avni Sahiti, dhe MF - z. Petrit Popova i cili nuk mori pjesë në takim. Në këtë takim ishte prezent edhe Kryesuesi i Kolegjiumit për Mirëqenie Sociale z. Bashkim Hyseni, përfaqësuesit nga projekti i DIFID-it dhe stafi i AKK-së.

Qëllimi i takimit ishte diskutim në bazë të rendit të ditës me këto pika: roli i Ministrive relevante dhe perspektiva e tyre në procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale, çështjet e arritura nga Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për decentralizimin e shërbimeve sociale, opsionet buxhetore dhe shërbimet sociale, kosto e njësisë dhe Skenari për shërbimet sociale, Zhvillimi i Kapaciteteve dhe nevojave individuale të Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa për të mbështetur decentralizimin e shërbimeve sociale dhe Kolegjiumin e SHMS-së për ushtrimin e kompetencave në fushën e shërbimeve sociale.

Drejtori Ekzekutiv i AKK- z. Sazan Ibrahim - Prezantoi në pika të shkurtra qëllimin e projektit të financuar nga DFID. Në bazë të informatave nga MPMS, kjo ministri planifikon që buxhetin për shërbime sociale për vitin 2012 të mos ia bart komunave, sepse ky buxhet do të shkrihet në grantin e përgjithshëm. MPMS-ja e ka parë të arsyeshme gjetjen e një formule financiare për shërbime sociale ngjashëm me grandet e arsimit dhe shëndetësisë. Sido që të jetë AKK kërkon që shërbimet të jenë sa më adekuate dhe sa më afër qytetarit.

AKK ka pasur takim me FMN-në dhe është arritur pajtimi që misioni i FMN-së të takohet dy herë me Bordin e AKK-së, një herë në fillim dhe një herë në fund të misionit. FMN nga raportet e marra nga Qeveria vlerëson se niveli i të hyrave vetanake të komunave ka rënë. Meqenëse ne e dimë se gjendja është e kundërt (të hyrat vetanake komunale janë në ngritje e sipër), kërkojmë nga çdo komunë të na dërgojnë të dhënat rreth të hyrave vetanake për tri vitet e fundit (2009-2011) në mënyrë që të argumentojmë me shifra konkrete se komunat janë duke kryer punën e tyre në nivelin më të lartë.

Drejtor i Departamentit për Hulumtime dhe Reformë të Pushtetit Lokal në MAPL - z. Avni Sahiti - prezantoi procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale në kuadër të reformës së pushtetit lokal, që nga krijimi i MAPL-së, dokumenti kornizë për reformën e pushtetit lokal, ndryshimet legislative, plani i veprimit për decentralizim, etj.

Po ashtu u prezantua misioni që MAPL ka në avancimin e qeverisjes lokale, kompetencat e MAPL-së, Marrëveshja e Mirëkuptimit për bartje të kompetencave të shërbimeve sociale, organizimi dhe kompetencat e Komunave, burimet financiare, etj (për më shumë detaje gjeni të bashkangjitur prezantimin).

Kryesues i Div. për Analiza Buxhetore dhe vlerësim të Varfërisë në MPMS - z. Mentor Morina – prezantoi bazën legislative për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga komunat (si Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe familjare dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale), përgjegjësit dhe obligimet e institucioneve për shërbimet sociale (MPMS, MAPL, MF dhe Komunitet), zhvillimin e procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, financimi i shërbimeve sociale pas bartjes së kompetencave, burimet e financimit për vitet 2012-2014, licencimi i ofruesve të shërbimeve sociale (stafi i QPS-ve dhe OJQ-të), si dhe sfidat dhe planet në të ardhmen (për më shumë detaje shihni prezantimin e bashkangjitur).

Pas këtyre prezantimeve të pranishmit shfaqën vështirësitë me të cilat ballafaqohen komunat pas decentralizimit të shërbimeve sociale. Më konkretisht komunat shfaqën nevojën për trajnimin e stafit komunal dhe të QPS-ve rreth përgjegjësi të reja, profesionalizmin e stafit (punësimin e psikologëve, pedagogëve, sociologëve, etj), krijimin e kushteve elementare për punën e QPS-ve, bartjen e plotë të kompetencave, sigurimin e financimit përmes një formule të qëndrueshme, reformën e asistencës sociale, informimin e Kryetarëve të Komunave për çështje të shërbimeve sociale, etj. Po ashtu u potencuar që QPS-të mund të gjenerojnë të hyra nga shërbimet administrative si dhe nevoja që QPS-të të kenë petty cash për nevoja të përditshme.

Kryesuesi I Kolegjiut për Mirëqenie sociale - z. Bashkim Hyseni - theksoi se procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale është bërë që nga viti 2009, mirëpo ne kemi filluar tani të marrim kompetencat dhe këto kompetenca nuk janë të plota. Nga niveli qendror nuk kemi pasur ndonjë model/mësim se si të ofrohen shërbimet sociale, e as informim konkret se si të vepohet më tutje.

Komuna e Ferizajt ka 220 familje të cilave iu është ndërpre asistencë sociale për shkak të mospërbushjes së kriterit 'fëmija nën moshën 5 vjeç'. Në këtë rast Komuna e Ferizajt ka nda mjete nga subvencionet me qëllim të mbështetjes së këtyre familjeve, sepse këto familje edhe më tutje kanë nevojë për asistencë sociale.

Ndarja e Drejtorive Shëndetësi dhe Mirëqenie Social është një opsion që duhet shqyrtuar, mirëpo fuqizimi i Sektorit komunal për mirëqenie sociale është më se i domosdoshëm. Po ashtu kërkohet një komunikimi i ri, sepse stafi i QPS-ve kanë përgjegjësi të dyfishta duke raportuar në dy nivele, në komunë dhe MPMS, gjë që krijon probleme në kuptim të përgjegjësi dhe llogaridhënies (p.sh. këta punëtorë vlerësohen nga dy nivelet, dhe si duhet vepruar nëse vlerësimi dallon?).

Përfaqësuesi i MPMS-së theksoi se nga Ministria ka iniciuar që kriteri 'fëmija mbi moshën 5 vjeç' të ndryshohet, por për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore nuk ka kaluar në Kuvend.

Ekspert i projektit të DFID-it - z. Sharr Kurtishi – prezantoi në pika të shkurtra synimet, qëllimet dhe 4 komponentët e projektit të DFID-it: 1. Themelimi i KKKP-së; 2. Kriteret për alokimin e buxhetit; 3. Sistemet e përforcuara menaxhuese; dhe 4. Kapaciteti i përmirësuar i AKK-së dhe Kolegjiut (për më shumë detaje shih prezantimin e bashkangjitur).

Ekspert i projektit të DFID-it - z. Yuriy Dzhygyr - prezantoi dizajnimin e mekanizmit financues për ndarjen e resurseve për shërbimet e kujdesit social në Kosovë si dhe kriteret dhe opsionet e mundshme në këtë drejtim. U theksua se variabli i popullsisë nuk është relevant në rastin e shërbimeve sociale, prandaj projekti është duke punuar në identifikimin e variablave relevant në këtë drejtim (për më shumë informata gjeni të bashkangjitur prezantimin).

Ekspert i projektit të DFID-it - z. Sharr Kurtishi –paraqiti punën e bërë deri më tani në përcaktimin e kostos për njësi për shërbimet sociale si dhe opsionet e formulës buxhetore ku do të merren parasysh kostot e njësive të ndryshme të shërbimeve sociale si dhe variabla shtesë relevant. Momentalisht projekti është duke punuar në përcaktimin e volumit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve sociale të ofruara nga QPS-të, për ç'gjë kërkohet që komunat dhe QPS-të të plotësojnë disa formularë dhe të dërgojnë këto të dhëna te projekti për analizë (për më detajisht gjeni të bashkangjitur prezantimin).

Përfaqësuesja nga Ministria e Financave në Shqipëri – znj. Jolanda Mema – prezantoi sistemin e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet më të rëndësishme ligjore të miratuara. Strategjia e decentralizimit është e mbështetur në strukturën aktuale të Qeverisjes Vendore në Shqipëri si dhe statusin e saj juridik, të drejtat, autoritetin, kompetencat, përgjegjësit, ndarjen administrativo – territoriale, organizimin e

brendshëm administrativ, funksionimin si dhe raportet e qeverisjes qendrore me organet e zgjedhura të qeverisjes vendore.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale është përmirësuar korniza ligjore dhe është bërë decentralizimi i kompetencave për ndihmë ekonomike dhe shërbimet sociale. Fondet e kushtëzuara për ndihmë ekonomike, pagesa e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesja shoqërore, janë fonde të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale por i delegohen njësive të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesa ekonomike (për më shumë detaje gjeni prezantimin e bashkangjitur).

Pas këtyre prezantimeve të pranishmit diskutuan për rolin e Drejtorëve për buxhet dhe financa dhe si mundën ata të ndihmojnë në aspektin financiar për ofrim sa më të mirë të shërbimeve sociale (p.sh. gjenerimi i të hyrave nga QPS-të, menaxhimi i petty cash-it, etj). Për më tepër u diskutua edhe për nevojat për ngritje të kapaciteteve ku u potencuan nevojat për trajnim të Drejtorëve për buxhet dhe financa rreth formulës së financimit si dhe kostos për njësi, pastaj trajnim për DSHMS-të dhe QPS-të, informimi më i mirë i Kryetarëve të komunave në mënyrë që shërbimet sociale të hynë në listën e prioriteteve, etj.

Të gjithë pjesëmarrësit shprehën mendimet e tyre në lidhje me vështirësitë dhe sfidat pas decentralizimit të shërbimeve sociale, si dhe sugjeruan që në vitin e ardhshëm të alokohen mjete adekuate për shërbimet sociale. Në fund të takimit u sugjeruar të mbahet një takim i përbashkët me Kolegjiumin për Buxhet dhe Financa si dhe Kolegjiumin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me qëllim të diskutimit të këtyre sfidave dhe vendosjes së hapave të mëtutjeshëm në përmirësim të cilësisë së shërbimeve.

### **Rekomandimet dhe Konkluzionet**

- i. Komunitat të përcjellin në AKK të dhënat për të hyrat vetanake për vitet 2009-2011, me qëllim të paraqitjes së tyre para Fondit Monetar Ndërkombëtar
- ii. QPS-të të gjenerojnë të hyra nga shërbimet administrative (p.sh. heqja e nënshtetësisë) dhe të kenë petty cash për nevoja të përditshme;
- iii. Decentralizim i plotë i kompetencave në nivel lokal, përfshi edhe pagesën e beneficioneve në kesh;
- iv. Të ndryshohen kriteret e asistencës sociale (të mos ndërpritet asistenca pasi që fëmija mbush 5 vjet);
- v. Krijimi i një komunikimi të ri mes institucioneve relevante në mënyrë që të precizohet përgjegjësia dhe llogaridhënia;
- vi. Shqyrtimi i mundësive për kompletim të stafit profesional në QPS (psikolog, pedagog, etj). Për shkak të kufizimeve të punësimit të stafit të ri, të shqyrtohet mundësia që të bëhet rotacioni i stafit;
- vii. Trajnimi i zyrtarëve të QPS-ve (Drejtori dhe stafi tjetër) dhe komunave (Drejtori i SHMS dhe stafi tjetër). Pozita e Shefit të Sektorit të Mirëqenies sociale në komuna të fuqizohet në veçanti. Në këtë aspekt komunitat mund të zhvillojnë kapacitetet e tyre duke u bazuar në përvojën dhe ekspertizën e stafit të QPS-ve;
- viii. Trajnim për Drejtorët për buxhet dhe financa në instrumentet e reja për financim të shërbimeve sociale;
- ix. Informimi i Kryetarëve të komunave rreth shërbimeve sociale.